

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **62500-25-1721-2-1-1**

Sa i përket tenderit për :“ **MIRËMBAJTËJA E NXEMJEVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E MALISHEVËS** “

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

EKOTERMIKA'' SH.P.K, "HARST Group" Sh.p.k. "CONSTRUMAX'' SH.P.K _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Blerim Krasniqi p.n. Bukoshe _____
(Adresa)

Suharekë _____ 23000 _____
(Vendi) (Kodi postar)

+38349660119 _____
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Arlind Krasniqi _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
Rr. Blerim Krasniqi p.n. Bukoshe _____
(Adresa elektronike)

04.07.2025 _____
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë 12.03.2025

Proceverbali i hapjes 11.04.2025

Leter standarde për sqarimin e tenderit 08.05.2025

Njoftimi për vendim 17.06.2025

Kerkesa për rishqyrtim 22.06.2025

Vendim ndaj kerkese për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi

Neni 62 i LPP-së- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 9 i LPP-së – Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

Neni 22 i LPP-së – Inicimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në lidhje me projektin **MIRËMBAJTËJA E NXEMJEVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E MALISHEVËS** me nr te prokurimit : **62500-25-1721-2-1-1** dhe me datë 17.06.2025 ka marru vendim për anulim Konzorciumi i jonë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 22.06.2025 dhe e cila me datë 25.06.2025 është refuzuar pa asnjë sqarim por vetëm ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se AK nuk ka bërë asnjë shkelje kjo mënyrë e kthimit konfirmon edhe njëherë vendimin e jashtligjshëm të AK Komuna e Malishevës pasi nuk kanë mundur të aryetohen në asnjë mënyrë këtë vendim të jashtligjshëm.

AK ka bërë shkelje të LPP pasi pa asnjë bazë ligjore ka anuluar procedurën tenderuese duke u mos bazuar në asnjë nenë të LPP , me ç' rast neve si palë e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët na është bërë padrejtësi dhe dëm.

Më posht gjeni pretendimin ton Ankimor:

Pretendimi - Lidhur me vendimin per Anulimin e procedurës tenderuese

AK Komuna e Malishevës me vendimin për anulimin e procedurës tenderuse ka bërë shkelje të LPP-së më saktësisht :

Neni 1 Qëllimi

Neni 62 i LPP-së- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

Neni 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Duke u bazuar ne LPP arsyet e vetme për të cilat mund të anulohet një procedurë tenderuese janë :

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Pra asnjë nenë i LPP-së nuk përcakton se një procedurë tenderuese mund të anulohet duke u thirrur në vendime që procedurat përmbartimore kanë marrur buxhetin e planifikuar , e sidomos në këtë rast kur procedura është kontratë Kornizë për mirëmbajtje 3 (tri) vjeqare e sisteme të ngrohjes të objekteve publike të Komunës së Malishevës, dhe duhet të mirret parasysh që edhe në rast që buxheti i këtij viti nuk është AK ka mundësin e ndarjeve buxhetore gjatë dy viteve të ardhshme .

Poashtu për të filluar një procedurë secili AK duhet të respektojë këta hapa: për publikimin e një procedurë tenderuese është që ZKA duhet të caktojë një person që të shërbej si person zyrtar Autorizues për këtë aktivitet të prokurimit.Dhe të njëjtit duhet ti dorëzohet Deklaratën përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Andaj duke u bazuar në procedurat standarte dhe duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik të Kosovës asnjë procedurë tenderuese nuk mund të fillohet nëse nuk janë dorëzuar deklarata e nevojave dhe disponueshmërin e fondeve.

AK ka shkelur nenet e lartëcekura pasi që dihet që qëllimi i AK është fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efikase, transparente dhe që do të respektohen procedurat ligjore, me ç'rast AK nuk ka respektuar këto procedura dhe supozjmë që dëshira e madhe e AK që të kalon ofertën tonë dhe të shpërblej dikënd tjetër ju ka imponuar shkeljen e procedurave dhe LPP-së me të vetmin qëllim që ne mos të shpërblehemi dhe në pamundësi tejkalimit të ofertës tonë AK zgjedhur variantën e anulimit të procedurës.

Ky anulim i procedurës është bërë në mënyrë arbitrare dhe duke mos u bazuar në asnjë nenë dhe ligj të prokurimit publik por vetëm duke u thirrur në një vendim . Atëherë forma e veprimit të tillë e AK duke u thirrur në vendime që dëmtojnë buxhetin Publik dhe dëmtojnë Kompanit që operojnë në tregun tonë paraqesin shkelje të LPP-së.

Supozojmë se më këso vendimesh secili AK do të mund të anulonte procedurat sipas dëshirës së tyre dhe do të mund të ritenderonin një procedurë deri në plotësimin e dëshirave dhe preferencave të AK-se.

Poashtu gjatë qasjeve në dokumentet e ofertueseve tjerë dhe dokumentacionit të vlerësimit kemi vërejtur se se komisioni i caktuar na ka përzgjedhur neve si të rekomanduar për shpërbllim me kontratë , dëshmi :

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:						
1	MIRËMBAJTËJA E NXEMJEVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE SHËNDËTËSORE NË KOMUNËN E MALISHEVËS						
	<table><tr><th>Emri i tenderuesit të suksesshëm</th><th>Kodi postar</th><th>Adresa</th></tr><tr><td>Grup i Operatorëve Ekonomik EKOTERMIKA SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.</td><td>230000</td><td>Rr. Blerim Krasniqi p.n</td></tr></table>	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa	Grup i Operatorëve Ekonomik EKOTERMIKA SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.	230000	Rr. Blerim Krasniqi p.n
Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa					
Grup i Operatorëve Ekonomik EKOTERMIKA SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.	230000	Rr. Blerim Krasniqi p.n					

DEKLARATË

(të deklarohej komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim)

KOMISIONI REKOMANDON DHËNJEN E KONTRATËS : GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK EKOTERMIKA SH.P.K.; HARST GROUP SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K., RR. BLERIM KRASNIQI P.N, 230000, BUKOSH, KOSOVË PASI QË KA OFRUAR OFERTEN PËRGJEGJËSE ME ÇMIMIN MA TË ULTË.

Pra AK nuk ka respektuar asnjë procedurë dhe ka anuluar procedurën tenderuese në mënyrë arbitrare duke u thirrur në fakte jorelevante duke i krahasur me LPP , dhe dihet se qdo vendim apo procedurë duhet të jetë në përputhje LPP dhe udhëzuesve.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, Ankesa e GOE Ekotermika Sh.p.k “Harst Group” SH.P.K. & Construmax Sh.p.k.. si e bazuar

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për Anulim dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së dhe ne si **GOE të përgjegjshëm dhe me me çmim më të ulët të shpërblehemi me kontratë.**

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në instanca tjera ligjore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe damtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin në vlerë prej 271,724.50Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.